



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:162268

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05354034

Ac.nr.4896/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.K., nga C..... ONN7L 0A4 Rr. “DR H.....”, nr.XX, O....., shteti i Kanadasë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.K., avokat nga Lipjani, kundër të paditurit B.S., nga Lipjani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H., avokat nga Lipjani, me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.33/2017 të datës 16.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditëses F.K., nga C..... ONN7L 0A4 Rr. “DR H.....”, nr.XX, O....., shteti i Kanadasë, ndërsa pika I dhe II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.33/2017 i datës 16.02.2021, VËRTETOHET.

II.Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.33/2017 i datës 16.02.2021, mbetet e pashqyrtuar (paprekur).

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.33/2017 të datës 16.02.2021, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses F.K., nga C..... ONN7L 0A4 Rr. “DR H.....”, nr.XX, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri B.M.S., nga Lipjani, që paditëses t’ia kompensoj dëmin në shumë prej 6,552.90 euro, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 03.0.2017, e deri te pagesa përfundimtare, si dhe t’ia kompensoj

shpenzimet e procedurës kontestimore. Në pikën dy, ka refuzuar propozimin e paditëse për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar që paditurit B.S., nga Lipjani, t'i ndalohet disponimi me mjetet materiale në shumë prej 7,206.28 euro, të deponuar në llogarinë bankare nr. XXXXXX në TEB bankë, si dhe të obligohet TEB banka me seli në Prishtinë, që të mos lejoj të paditurin tërheqjen e këtyre mjeteve materiale nga kjo llogari bankare. Në pikën tre, ka obliguar paditësen që të paditurit te ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 868.40 euro, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta miratoj ankesën, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të prish dhe lëndën ta kthej në rivendosje të serishëm ose ankesën ta miratoj, aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditëses ta miratoj në tërësi.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i të paditurit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e paditëses ta refuzoj si të pabazuar kurse aktgjykimin C.nr.33/17 ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja kundër të paditurit, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 15.02.2021, ka kërkuar që të detyrohet i padituri për kompensimin e dëmit material në shumën prej 6,552.90 euro.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: certifikata e martesës e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Lipjan e dt.06.02.2017, fletëpranimi R.... dt.15.12.2014, në shumën 1.600 dollar kanadez, të njëjtën datë shumën 500 dollar kanadez, dt.25.02.2015, 2,825 dollar kanadez, fatura nr.20685 e dt.14.12.2014, shkresa nga firma ligjore e I.... G..... dt.24.04.2017 në emër të paditëses, shkresa e dt.18.07.2016, fatura nr.864127 e dt.20.01.2017, njoftimi i dt.30.01.2017 dhe ekspertiza financiare e dt.18.01.2021. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të mos ekzistimit të bazës së kërkesëpadisë ka vendosur lidhur me refuzimin e të njëjtës duke u bazuar në dispozitat e nenit 136, paragrafi 1 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund ekzaminohet, arsyetimi dhe dispozitivi i tij janë të pakuptueshëm. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Aktgjykimi përmban edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që në bazë të provave të administruara, dhe se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të lartcekura e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, sa i përket kërkesës së refuzuar sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 136, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në rastin konkret, nga provat e administruara nuk mund të vërtetohet se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses me fajin e tij, dhe se nga dispozita e lartcekur rezulton se i njëjti nuk është përgjegjës që të shpërblej dëmin.

Gjithashtu, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditëses, se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses në kuptim të nenit 137 të LMD-së, sepse paditësja me asnjë provë nuk e ka vërtetuar dëmin e tillë, për shkak të ndarjes dhe mosmarrëveshjeve që ka pasur me të paditurin, që ky dëm konsiston në zvogëlimin e pasurisë (dëm i zakonshëm) dhe pengimin e rritjes së asaj pasurie (fitim i humbur), i cili sipas dispozitës së lartë cekur duhet të provohet me prova materiale, e që nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se paditësja ka pësuar këto lloje të dëmit material, andaj edhe pretendimi i tillë ankimor është refuzuar i pabazuar.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi që kjo pjesë të dispozitivit të aktgjykimit nuk është atakuar përmes ankesës së ushtruar nga e të autorizuarit të paditëses.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4896/2021, me datë 06.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v,